

RAPORT MBI SITUATËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË DHOMAT E SHOQËRIMIT DHE NDALIMIT NË DISA KOMISARIATE POLICIE

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), organizata e parë e të drejtave të njeriut e krijuar në vitin 1990 ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar në institucionet penitenciare, prej vitesh ka qenë në vemendjen e veçantë të KSHH-së.

Gjatë muajit korrik 2009, KShH vëzhgoi dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit në komisariatet e policisë së rrethit Berat, Fier, Vlorë, Sarandë dhe Burrel.¹

Objektivat kryesore të këtyre të vëzhgimeve ishin: vëzhgimi i kushteve të jetesës së personave të ndaluar dhe të shoqëruar në komisariatet e policisë, vëzhgimi i respektimit të të drejtave të këtyre personave nga personeli i komisariateve si dhe kontaktet të drejtëpërdrejta me personat e ndaluar ose të shoqëruar si dhe verifikimi i ankesave dhe shkeljeve të pretenduara.

Në vëzhgim morën pjesë grupi i ekspertëve të KSHH-së dhe stafi i tij. **Metodologjia e përdorur në këto vëzhgime është:** marrja e takimeve me përfaqësues të administratës të institucioneve dhe me personelin, vëzhgime në terren i ambjenteve, pajisjeve të dhomave të ndalimit dhe shoqërimit si dhe ambjentet e përbashkëta në Komisariatet e vëzhguara si dhe takime me personat e ndaluar dhe të shoqëruar.

Ndryshe nga mikpritja pothuajse në të gjitha vëzhgimet, vlen të përmendim një fakt negativ, se vëzhguesit e KShH-së nuk u lejuan që të vëzhgonin dhomat e ndalimit në Drejtorinë e Qarkut Fier, pavarësisht se KShH kishte marrë lejen përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Vëzhguesit e KShH-së morrën takim me nëndrejtorin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier jashtë ambienteve të këtij institucioni si dhe u mbajtën disa orë jashtë këtyre ambienteve duke ju premtuar se do të lejoheshin të vëzhgonin pavarësisht se ishin “sorollatje” nga ana e kësaj Drejtorie.

1. Infrastruktura dhe kushtet fizike

KShH, si rezultat i vëzhgimeve konstatoi se, përveç Komisariatit të Fierit, infrastruktura e ambienteve të ndalimit dhe shoqërimit në komisariatet e policisë të vëzhguara nuk ka pësuar përmirësime. ***Infrastruktura nuk plotësonte kushtet minimale për një trajtim njerëzor dhe me dinjitet të personave të ndaluar dhe të shoqëruar.*** Prania e lagështirës, mungesa e ajrimit dhe e ndriçimit natyror, mungesa e pajisjeve kryesore si krevatet, dyshekët dhe batanijet, kubatura shumë e vogël e dhomave të ndalimit dhe shoqërimit, vazhdojnë të jenë probleme ekzistente, edhe pse tashmë të konstatuara në vëzhgimet me rradhë që KSHH ka kryer.

¹ Misionet e monitorimit janë mundësuar falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit në kuadër të programit “Për një respektim më të mirë të të drejtave të viktimave në Shqipëri- Klinika ligjore 3”

Kushte të këqija infrastrukturore dhe fizike u vunë re në Komisaritet e Vlorës, Burrelit dhe Sarandës. Në këto komisariate, dhomat e ndalimit dhe shoqërimit nuk plotësonin as kushtet minimale të jetesës. Kishte mungesa të ajrimit dhe ndriçimit natyror, lagështirë, të krevateve dhe orendive të tjera, personat e ndaluar/shoqëruar qëndronin në tokë me dyshekë ose batanije për shkak të mungesës së ambjentëve.

Disa komisariate si ai i Vlorës, Sarandës dhe Burrelit **nuk kanë patur asnjë lloj rikonstruksioni duke bërë qëndrimin e personave të ndaluar dhe të shoqëruar në kushte të tilla, jonjerëzore dhe degradues.** KShH ka reaguar disa herë me deklarata publike për gjendjen e rëndë të këtyre institucioneve por përsëri rikonstruksionet e tyre mbeten vetëm plane.

Komisariati i Beratit për shkak të mungesës së ambjentëve, personat e shoqëruar (deri në 10 orë) i mbante në godinën e saj, në dy ambjente të caktuara, ndërsa personat e ndaluar i dërgonte në Drejtorinë e Policisë së Fierit duke sjellë për efektivat e policisë një vështirësi të madhe në mbarëvajtjen e punës së përditshme.

Komisariati i Fierit ku qëndronin vetëm personat e ndaluar gjendej në kushte të mira infrastrukturore, për shkak se ky komisarifat është një institucion i ri. Ambjentet e këtij komisaritati ishin të pajisura me kolltuqe dhe tavolina. Aktualisht në Fier funksiononin 2 ambjente: **Drejtoria e Policisë së Qarkut të Fierit (DPQF)** ku ndodheshin dhomat e ndalimit për qytetarët e prefekturave të Fierit dhe Beratit, në të cilat vendoseshin qytetarët e ndaluar ndaj të cilëve bëhej vleftësimi i masës së sigurisë nga gjykata, si dhe **Komisariati i Fierit** ku ishin dhomat e shoqërimit. Nga informacioni i marrë, dhomat e paraburgimit në DPQF ishin në të njëjtën gjendje si vite më parë, majde ishin amortizuar akoma edhe më shumë, si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes së tyre.

2. Kapaciteti

KShH konsideron **si problematike kapacitetin që ofrojnë ambientet e Komisariateve të vëzhguara, i cili është i pamjaftueshëm**, veçanërisht në rastet kur ka fluks personash të ndaluar dhe të shoqëruar dhe ndërkohë që masat e vlerësimit të dhëna nga gjykata janë “arrest me burg”. Dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit në komisaritet e policisë ishin të vogla jo vetëm në kubaturë por edhe në numër. Dhe në ato komisariate ku numri i dhomave ishte i madh për shkak të funksionimit më përpara si paraburgim, pjesa më e madhe e dhomave kanë dalë jashtë përdorimit, **si në rastin e Komisaritatit të Burrelit.**

Komisariati e Vlorës kishte 2 dhoma shoqërimi, 2 dhoma ndalimi për të rritur dhe 1 dhomë ndalimi për të mitur. Në dhomat e ndalimit qëndronin mesatarshit 4-8 persona. Pavarësisht se kriminaliteti në rrethin e Vlorës, kishtë pësuar rënie krahasuar me periudhat e mëparshme, kjo nuk përjashtonte mundësinë e rritjes së tij në të ardhmen.

Në Komisariatin e Sarandës, për shkak të kapacitetit shumë të ulët dhe kushteve jo të mira (2 dhoma), KShH u informua se, gratë dhe të miturit e ndaluar dhe të shoqëruar, mbaheshin në ambjente të tjera të tjerë të këtij komisaritati, si në zyrën e informacionit ose në zyrën e pritjes së qytetarëve.

Në Komisariatin e Beratit ashtu siç u përmënd dhe më sipër, situata paraqitet ndryshe, pasi në këtë komisarifat ndodhen vetëm 2 dhoma shoqërimi. Personat e ndaluar në këtë rreth, dërgoheshin në Drejtorinë e Policisë Fier, për shkak të mungesës së ambienteve në Komisariatin e Beratit. Deri në 3 persona të ndaluar në ditë transferoheshin nga Komisaritati i Beratit në Drejtorinë e Policisë Fier. Zgjidhja e gjetur ishte e papërshtatshme, jo vetëm për shkak të mungesës së personelit që do mundësonte transferimin, por ishte njëkohësisht e lodhshme për të gjitha palët, përfshirë edhe familjarët e personave. KShH u informua se shkak i këtij transferimi ishte prishja e marrëveshjes mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe

Drejtorisë së Policisë së Shtetit ku Komisariati i Beratit përdorte si dhoma ndalimi, dy dhoma nga Institucioni i paraburgimit të Beratit, i cili ndodhej gjithashtu në kushte tepër të këqija dhe me një mungesë të theksuar të ambjenteve.

Komisariati i Fierit kishte kapacitet të ulët, deri në 24 persona. Ndërkohë, kapaciteti i dhomave të paraburgimit në Drejtorinë e Policisë Fier ishte 110 persona. Situata do të rëndohet veçanërisht, duke qenë se dhomat e paraburgimit të Drejtorisë së Policisë Fier, priteshin të transferoheshin së shpejti në ambjentet e Komisarariatit të Fierit, të cilat nuk e kanë kapacitetin e nevojshëm për të përballuar këtë transferim.

3. Personeli

KSHH gjatë vëzhgimit mori informacion se *kishte mungesa në organikën e disa Komisariateve*. Kishte mungesë të mjekut dhe të psikologut në Komisariatin e Vlorës, mungesa e psikologut në Komisariatin e Beratit. Tepër urgjente është plotësimi i organikës së Komisarariatit të Sarandës me personel femra.

Nga informacionet e marra, kishte mungesa të punonjësve të policisë në Komisariatin e Burrelit. Specifika dhe dinamika e kriminalitetit në këtë rreth kërkon të nevojshme shtimin e numrit të punonjësve të policisë. Numri i punonjësve të policisë në këtë komisariat ishte në nivele të ulëta krahasuar me numrin e banorëve. Gjithashtu, shtimi i punonjësve femra mbetet prioritet.

4. Kushtet higjieno-sanitare

Nga vëzhgimi rezultoi se kushtet higjieno-sanitare në disa nga komisarariatet e vëzhguara linin për të dëshiruar, konkretisht në Komisariatin e Sarandës dhe atë të Vlorës. Në Komisariatin e Sarandës për më tepër kishte papastërti jo vetëm në ambientet e brendshme por edhe në ato të jashtme, të cilat ishin të mbuluara nga plehrat e shumta. Qëndrimi i personave të ndaluar dhe të shoqëruar në këto kushte vë në rrezik edhe shëndetin e tyre pasi mund të jetë burim vatrash infeksioni dhe sëmundjesh.

5. Afatet e ndalimit dhe shoqërimit

Grupet e vëzhgimit të KSHH-së kontaktuan se kishte *tejzgjatje të afateve të mbajtjes së personave të dënuar në mungesë në dhomat e ndalimit në ambjentet e komisariateve*, sidomos në Komisariatin e Vlorës dhe të Beratit (të cilët dërgoheshin në Drejtorinë e Policisë Fier). *Nga takimet me përfaqësues të Komisariateve u informuam se nga momenti i ndalimit të personave të dënuar në mungesë deri në miratimin e vendit të vuajtjes së dënimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe transferimin e tyre në burgje, kalonte një kohë relativisht e gjatë*. Kishte raste kur këta persona qëndronin në dhomat e ndalimit deri në 10 ditë.

6. Ushqimi

KSHH vazhdon të konstatojë se në shumicën e komisariateve të vëzhguara, personave nuk u sigurohej ushqimi, konkretisht në Komisariatin e Sarandës, Beratit dhe Vlorës. Në këto komisariate janë efektivët e policisë ata që u ofrojnë ushqim personave të ndaluar ose të shoqëruar, sidomos në ato raste kur janë të braktisur nga familja.

Në Komisariatin e Beratit, pavarësisht se brenda godinës së këtij institucioni ndodhej guzhina e paraburgimit të Beratit, vetë Komisariati s'kishte kuzhinë dhe personave të shoqëruar nuk u

jepej ushqim. Pothuajse në të gjitha komisariatet ishin policët ata që me paratë e tyre i ofronin ushqime të ndryshme personave të ndaluar dhe të shoqëruar.

7. Asistimi me materiale sensibilizuese/informuese

KSHH konstatoi se në ambjentet e disa komisariateve nuk kishte materiale sensibilizuese ose informuese të afishuara. Për këtë arsye, e konsiderojmë të rëndësishme afishimin e materialeve sensibilizuese dhe informuese në ambientet e Komisariateve, nëpërmjet të cilave personat e shoqëruar dhe të ndaluar të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore.

Rekomandime drejtuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Komisariateve të vëzhguara

1. Përshpjëtimi i procesit të rikonstruksionit dhe përmirësimit të kushteve të dhomave të shoqërimit dhe të ndalimit të Komisariateve Vlorë, Sarandë, Burrel si dhe dhomat e ndalimit në Drejtorinë e Policisë së qarkut Fier. KSHH thekson se ky shqetësim duhet të jetë prioritar dhe të mund të gjejë zgjidhje sa më të shpejtë.
2. Marrja e masave për zgjidhjen sa më parë të problemit të transferimit të menjëhershëm të personave të dënuar në mungesë, me qëllim evitimin e qëndrimit të tyre me ditë të tëra në komisariate. Për këtë arsye KSHH sugjeron firmosjen e një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që personat të dënuar në mungesë, të kapur rishtaz, të transferohen menjëherë në institucionet e vuajtjes së dënimit. Kjo do të përmirësonte ndjeshëm situatën e respektimit të të drejtave të këtyre personave por njëkohësisht dhe do të lehtësonte punën e stafit policor që punonte dhe qëndronte në këto dhoma.
3. Të kryhen trajnime të stafëve policor në mënyrë të vazhdueshme, pothuajse në të gjitha Komisariatet, sidomos për çështjet e të drejtave të njeriut.
4. Gjithashtu, shihet e nevojshme asistimi i Komisariateve si ai i Vlorës, Burrelit, Sarandës dhe Beratit me materiale sensibilizuese dhe informuese për të drejtat e njeriut.
5. Mundësimi i një fondi për komisariatet që nuk ofrojnë ushqim për personat e ndaluar dhe të shoqëruar, me qëllim blerjen e teshave dhe ushqimeve, sidomos për personat e braktisur nga familja.
6. KSHH rekomandon që të zgjidhet situata midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit lidhur me dhomat e ndalimi me qëllim që të mos transferohen personat nga Berati në Fier.
7. Të krijohet mundësia e shtimit të personelit policor, gjë që do të siguronte një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut por dhe lehtësim të punës së personelit policor, konkretisht në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier, Komisariatit të Burrelit, Komisariatit të Sarandës. Ose do të sugjeronim të bëhet një ndarje më e mirë e punës midis stafit ekzistues.
8. KSHH rekomandon plotësimin e organikës në mënyrë të menjëhershme me punonjëse femra në Komisariatit të Sarandës.

Tiranë më, 9 Nëntor 2009